



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1600/ 8 prot.,

Datë 17 .06.2026

V E N D I M
Nr. 817/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17 .06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Luar Bros” shpk për në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k, me Nipt, K71820009I, dhe adresë: Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8 , Tirane, Tirana.
- Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF, me NIPT (L61608005C) dhe adresë: Rruga Muhamet Veliu, Pallati 3D ,Njesia me nr.Pasurie 475/103-G15, ZK:2460.
- Operatori ekonomik “Zeqiri” shpk, me Nipt, J67902827A, dhe adresë: Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private , Pasuria nr. 1/1088, Kati.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh, me adresë: Lagja 13, Rruga: Dhimiter Kraja.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Luar Bros” shpk, me NIPT L72322004M dhe adresë: Rruga Ali Demi , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.,

në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomik kanë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14-04-2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

II.2. Në datën 28.04.2026, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.Zeqiri	3.216.000	leke skualifikuar
2. Leon Konstruksion	3.588.000	leke skualifikuar
3.Luar Bros	3.750.000	leke kualifikuar
4.Malvina Visoka	3.750.000	leke kualifikuar
5. Arteo 2018	3.756.000	leke skualifikuar
6.SARK	4.200.000	leke skualifikuar

II.3. Në datën 19.05.2026, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datën 22.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. aplikimi A/2026/ 6705, dhe nr. 1603/2026 prot., datë 22.05.2026 e operatorit ekonomik “Zeqiri” shpk, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

II.5. Në datën 22.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. aplikimi A/2026/ 6605, dhe nr. 1600/2026 prot., datë 22.05.2026 e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658 04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

II.6Në datën 25.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. aplikimi A/2026/ 6712, dhe nr. 1628/2026 prot., dhe e protokolluar me dt 25.05.2026 e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF 81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), formularin për publikim me Nr. 1628/1 prot., datë 26.05.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” pf ku kundërshton me anë të ankesës kualifikimin e operatorit ekonomik “Luar Bros ” Sh.p.k, formularin për publikim Nr. 1600/1 prot., datë 25.05.2026 lidhur me pretendimet e “Leon Konstruksion ” SHPK ku kundërshton me anë të ankesës skualifikimin e tij si dhe formularin për publikim me nr 1603/1 datë 25.05. 2026 të operatorit ekonomik “Zeqiri” shpk ku kundërshton me anë të ankesës skualifikimin e tij .

II.8 Me shkresën nr. 1600/3 prot., datë 05.06.2026, Komisioni e Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues, “Leon Konstruksion” shpk lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën nr. 1603/3 prot. më tonën, datë 02.06.2026, autoriteti kontraktor informon mbi trajtimin e ankesës ku rezulton se nuk e ka pranuar.

II.10. Me shkresën nr. 1628/3 prot., më tonën datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor informon mbi trajtimin e ankesës ku rezulton se nuk e ka pranuar.

II.11.Me shkresën nr. 1600/4 prot., më tonën datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor informon mbi trajtimin e ankesës ku rezulton se nuk e ka pranuar, si dhe gjithashtu rezulton se ky informacion është përcjellë dhe në rrugë shkresore me shkresën me nr. 1600/5 prot me tonën datë 16.06.2026.

II. 12. Referuar parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik” i ndryshuar, rezulton se ka argumenta nga palët e interesuara, “Luar bros” shpk per ankesën 1603/2026 per ankesën 1628/2026 dhe per ankesën 1600/2026 të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cënohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Zeqiri” Sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, me arsyen se :...Kazanet te jene sipas standartit EN 840 ? 2 : 2020. Pra eshte shtuar si kerkese qe Kazanet te jene sipas standartit EN 840 ? 2 : 2020 Kjo kerkese eshte vendosur qartesisht ne seksionin e specifikimeve teknike te objektit te prokurimit dhe jo ne seksionin e kriterave te vecanta per kualifikim, ku percaktohen dokumentet dhe kushtet qe duhet te plotesojne operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit. Ne asnje pike te kriterave te kualifikimit nuk eshte kerkuar shprehimisht paraqitja e certifikates EN 840-2:2020 si dokument provues ne fazen e vleresimit te ofertave. Per rrjedhoje, kjo kerkese ka karakter teknik dhe lidhet me perputhshmerine e produktit ne fazen e ekzekutimit te kontrates, dhe jo me kushtet e kualifikimit te operatorit ekonomik. Per me teper, ne theksojme se kemi paraqitur Autorizim nga Prodhuesi, si dhe kemi bere deklarate zyrtare per permbushjen e plote te specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar qe malli i ofruar do te dorezohet ne perputhje te plote me kerketat e percaktuara ne DST, Ne perputhje me Ligjin nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik , Neni 2 dhe Neni 3, permenden shprehimisht parimet e transparences, trajtimit te barabarte dhe proporcionalitetit.. Si rrjedhoje vleresimi dhe skualifikimi i opereve ekonomik duhet te bazohet ekskluzivisht ne kriteret e vecanta te kualifikimit te percaktuara ne Dokumentet Standarde te Tenderit. Specifikimet teknike percaktojne karakteristikat e objektit te kontrates dhe nuk perbejne kushte kualifikimi per operatorin ekonomik, pervec rasteve kur nje kerkese e tille eshte percaktuar shprehimisht ne seksionin e kriterave te kualifikimit. Ne mungese te nje percaktimi te tille, perdorimi i specifikimeve teknike si baze per skualifikim perben interpretim te zgjeruar te DST dhe bie ndesh me parimet themelore te Ligjit te Prokurimit Publik dhe praktiken e konsoliduar te Komisionit te Prokurimit Publik. Operatori yne Ekonomik thekson se perputhshmeria me standardin EN 840-2:2020 garantohet plotesisht ne momentin e dorezimit te mallit, ku produkti do te shoqerohet me certifikaten perkatese, ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara.]. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III. 1 .1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 6 e ndryshuar dhe shtojcën 8, kerketat dhe kriteret si në vijim:

SHTOJCË

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Mbeshtetur ne pikën 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, per proceduren e prokurimit me nr **REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”**, njoftohen operatoret ekonomik te interesuar, per modifikime ne Dokumentat Standarte te Tenderit si me poshte:

Ne shtojcen 6, Formulari i Specifikimeve Teknike

ISHTE

- Kazan plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 litra,
- Dimensionet ($\pm 2\%$)
 - Gjerësi totale: 1390 mm
 - Gjerësi kapaku: 1190 mm
 - Gjatësi: 1080 mm
 - Lartësi totale: 1330 mm
 - Lartësi trupi: 1220 mm
 - Lartësi deri në bosht: 775 mm
 - Distanca rrotash (ballore): 850 mm
 - Distanca rrotash (anësore): 740 mm
 - Diametri rrotave: 200 mm
- Materiali
 - HDPE (Polietilen me densitet të lartë), rezistent ndaj UV, temperaturave (-20°C deri $+40^{\circ}\text{C}$), dhe kimikateve.
- Pesha
 - Pesha vetjake: 50 – 65 kg
- Kapaku
 - Kapak i fortë HDPE, i lidhur me trupin, rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike.
- Dorezat
 - Doreza ergonomike të integruara në trup për manovrim të lehtë.
 - Doreza të përforcuara për ngritje dhe zhvendosje.
- Rrotat
 - 4 rrota rrotulluese 360°
 - Diametër: 200 mm
 - Material: gomë e fortë / poliuretan
 - 2 rrota me sistem frenimi
- Kapaciteti dhe ngarkesa
 - Kapacitet: 1100 litra
 - Ngarkesa maksimale: ≥ 400 kg
- Karakteristika shtesë
 - Vrima kullimi me tapë
 - Sipërfaqe e lëmuar për pastrim
 - Rezistencë ndaj korrozionit
- Ngjyra do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës ,sipas kërkesave të AK

BËHET

- Kazan plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 litra,
- **Dimensionet ($\pm 5\%$)**
 - Gjerësi totale: 1390 mm
 - Gjerësi kapaku: 1190 mm
 - Gjatësi: 1080 mm
 - Lartësi totale: 1330 mm
 - Lartësi trupi: 1220 mm
 - Lartësi deri në bosht: 775 mm
 - Distanca rrotash (ballore): 850 mm
 - Distanca rrotash (anësore): 740 mm
 - Diametri rrotave: 200 mm
- Materiali
 - HDPE (Polietilen me densitet të lartë), rezistent ndaj UV, temperaturave (-20°C deri $+40^{\circ}\text{C}$), dhe kimikateve.
- Pesha
 - Pesha vetjake: 50 – 65 kg
- Kapaku
 - Kapak i fortë HDPE, i lidhur me trupin, rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike.
- Dorezat
 - Doreza ergonomike të integruara në trup për manovrim të lehtë.
 - Doreza të përforcuara për ngritje dhe zhvendosje.
- Rrotat
 - 4 rrota rrotulluese 360°
 - Diametër: 200 mm
 - Material: gomë e fortë / poliuretan
 - 2 rrota me sistem frenimi
- Kapaciteti dhe ngarkesa
 - Kapacitet: 1100 litra
 - Ngarkesa maksimale: ≥ 400 kg
- Karakteristika shtesë
 - Vrima kullimi me tapë
 - Sipërfaqe e lëmuar për pastrim
 - Rezistencë ndaj korrozionit

- Ngjyra do të percaktohet në momentin e lidhjes së kontratës, sipas kërkesave të AK

Kazanet të jene sipas standartit EN 840 – 2 : 2020.

ARGUMENTIME

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasinë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Materialet e kërkuara janë standarde dhe specifikimet e tyre janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionalitetin e produktit si dhe shërbimet profesionale të veprimtarisë së AK, sipas objektit të prokurimit. Materialet duhet të jenë funksionale dhe cilësore për realizimin e punës së perdritshme të specialisteve në terren. Specifikimet teknike janë kërkuar në përputhje me kërkesat e specialistëve të terrenit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ,2023,2024,2025 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit

nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapu e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ,2023,2024,2025 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/**distributori** i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi)

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklaratë në të cilën të marrë për vlerë përmbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar për çdo produkt sipas kërkesave të AK si dhe realizimin e kontratës sipas afatit 20 ditore.

2.3.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Certifikatat ISO Si më poshtë:

Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të përshkruar dhe notifikuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër mjeti nevojitet të jetë i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë të lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose

- çdo dokument tjetër me anë të cilin fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:


- Kontratë qiraje.
- Leje qarkullimi e mjetit.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori duhet të paraqes një moster fizike për mallin si më poshtë.

Nr	Emertimi i Mallit	Njesia	Sasia
1	Kazane plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra	Cope	1



Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, Data 24.04.2026, ora 10:00, pranë Ndermarrjes Komunale Plazh, Durrës, me adresë: Lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara .

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.
- Malli do të dorezohet në prani të komisionit të marrjes në dorezim në Magazinen e NKP Durrës, lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.
- Furnizimi do të bëhet brenda 20 diteve nga nënshkrimi i kontratës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

- Faturen Tatimore e Mallit
- Skeden teknike të produktit

Mos plotësimi i kriterëve të mesipërme nga ana e Subjektit Ofertues është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. 10 Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Ndërsa në nenin 92, pika 1, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1.

Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

III.1.3. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se : ...Kazanet te

jene sipas standartit EN 840 ? 2 : 2020. Pra eshte shtuar si kerkese qe Kazanet te jene sipas standartit EN 840 ? 2 : 2020 Kjo kerkese eshte vendosur qartesisht ne seksionin e specifikimeve teknike te objektit te prokurimit dhe jo ne seksionin e kriterëve te vecanta per kualifikim, ku percaktohen dokumentet dhe kushtet qe duhet te plotesojne operatorët ekonomik ne fazen e ofertimit. Ne asnje pike te kriterëve te kualifikimit nuk eshte kerkuar shprehimisht paraqitja e certifikates EN 840-2:2020 si dokument provues ne fazen e vleresimit te ofertave. Per rrjedhoje, kjo kerkese ka karakter teknik dhe lidhet me perputhshmerine e produktit ne fazen e ekzekutimit te kontrates, dhe jo me kushtet e kualifikimit te operatorit ekonomik. Per me teper, ne theksojme se kemi paraqitur Autorizim nga Prodhuesi, si dhe kemi bere deklarate zyrtare per permbushjen e plote te specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar qe malli i ofruar do te dorezohet ne perputhje te plote me kerkesat e percaktuara ne DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues është mospërmbushja e një kriteri kualifikimi të përcaktuar (fshehur) në specifikimet teknike të mallrave objekt - prokurimi dhe jo mospërputhja e specifikimeve teknike të mallrave objekt – prokurimi, nga operatori ekonomik ofertues. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, si dhe ka detyrë të përcaktojë kriterë dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me mallrat e kërkuara, por përcaktimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me parashikimet ligjore. Në rastin konkret, KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit kualifikues nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike të mallrave objekt - prokurimi vjen në kundërshtim si me nenin 36, pika 1, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet”, ashtu dhe me nenin 15, pika 1 e 3/b “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se :

”1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve dhe specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto të fundit duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori

ekonomik i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Duke u kthyer në rastin objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomikë “Zeqiri” SHPK” në procedurën e mësipërme të prokurimit, duhet të bëhet mbi bazën e kriterëve të kualifikimit të parashikuara në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit dhe jo në bazë të një kriteri të vendosur (fshehur) në seksionin e specifikimeve teknike, pasi LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcaktojnë qartë përmbajtjen e shtojcave specifike të procedurave të prokurimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Zeqiri” sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, për skualifikimin e tij nga autoriteti kontraktor me arsyen si më poshtë vijon:

...[Autoriteti kontraktor ka arsyetuar skualifikimin me pretendimin senuk provohet përputhshmëria e kazanëve me standartin EN 840-2:2020. Ndërkohë në katalogun teknik të prodhuesit pjesë e ofertës sonë është deklaruar qartësisht përputhshmëria me standartin EN 840-2. Mungesa e specifikimit formal të vitit 2020 nuk përbën provë për mungesë standari apo mospërputhje teknike të produktit të ofruar. Nëse autoriteti ka pasur ndonjë ndonjë dyshim ishte i lutur të kërkonte të paraqitej specifikisht ISO EN 840-2:2020 ndërkohë që në shtojcë shkruhet kazanet te jene sipas standartit “EN 840-2:2020” . Autoriteti ne DST është mjaftuar vetëm me paraqitjen e iso 9001:2015 sic shprehet edhe në Pikën 2.3.2 të DST.]...

III. 2 .1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 6 e ndryshuar dhe shtojcën 8, kërkesat dhe kriteret si në vijim:

SHTOJCË

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Mbeshtetur ne pikën 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, per procedurën e prokurimit me nr **REF-81658-04-10-2026, me objekt** “Blerje kazan plastik”, njoftohen operatorët ekonomik te interesuar, per modifikime ne Dokumentat Standarte te Tenderit si me poshte:

Ne shtojcen 6, Formulari i Specifikimeve Teknike

ISHTE

- Kazan plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 litra,
- Dimensionet ($\pm 2\%$)
 - Gjerësi totale: 1390 mm
 - Gjerësi kapaku: 1190 mm
 - Gjatësi: 1080 mm

- Lartësi totale: 1330 mm
- Lartësi trupi: 1220 mm
- Lartësi deri në bosht: 775 mm
- Distanca rrotash (ballore): 850 mm
- Distanca rrotash (anësore): 740 mm
- Diametri rrotave: 200 mm

- Materiali
 - HDPE (Polietilen me densitet të lartë), rezistent ndaj UV, temperaturave (-20°C deri +40°C), dhe kimikateve.
- Pesha
 - Pesha vetjake: 50 – 65 kg

- Kapaku
 - Kapak i fortë HDPE, i lidhur me trupin, rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike.
- Dorezat
 - Doreza ergonomike të integruara në trup për manovrim të lehtë.
 - Doreza të përforcuara për ngritje dhe zhvendosje.

- Rrotat
 - 4 rrota rrotulluese 360°
 - Diametër: 200 mm
 - Material: gomë e fortë / poliuretan
 - 2 rrota me sistem frenimi

- Kapaciteti dhe ngarkesa
 - Kapacitet: 1100 litra
 - Ngarkesa maksimale: ≥ 400 kg

- Karakteristika shtesë
 - Vrima kullimi me tapë
 - Sipërfaqe e lëmuar për pastrim
 - Rezistencë ndaj korrozionit

- Ngjyra do të percaktohet në momentin e lidhjes së kontratës, sipas kërkesave të AK

BËHET

- Kazan plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 litra,
- **Dimensionet ($\pm 5\%$)**

- Gjerësi totale: 1390 mm
- Gjerësi kapaku: 1190 mm
- Gjatësi: 1080 mm
- Lartësi totale: 1330 mm
- Lartësi trupi: 1220 mm
- Lartësi deri në bosht: 775 mm
- Distanca rrotash (ballore): 850 mm
- Distanca rrotash (anësore): 740 mm
- Diametri rrotave: 200 mm

- Materiali
 - HDPE (Polietilen me densitet të lartë), rezistent ndaj UV, temperaturave (-20°C deri +40°C), dhe kimikateve.
- Pesha
 - Pesha vetjake: 50 – 65 kg

- Kapaku
 - Kapak i fortë HDPE, i lidhur me trupin, rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike.
- Dorezat
 - Doreza ergonomike të integruara në trup për manovrim të lehtë.
 - Doreza të përforcuara për ngritje dhe zhvendosje.

- Rrotat
 - 4 rrota rrotulluese 360°
 - Diametër: 200 mm
 - Material: gomë e fortë / poliuretan
 - 2 rrota me sistem frenimi

- Kapaciteti dhe ngarkesa
 - Kapacitet: 1100 litra
 - Ngarkesa maksimale: ≥ 400 kg

- Karakteristika shtesë
 - Vrima kullimi me tapë
 - Sipërfaqe e lëmuar për pastrim
 - Rezistencë ndaj korrozionit

- Ngjyra do të percaktohet në momentin e lidhjes së kontratës ,sipas kërkesave të AK

Kazanet të jenë sipas standartit EN 840 – 2 : 2020.

ARGUMENTIME

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Materialet e kërkuara janë standarde dhe specifikimet e tyre janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionalitetin e produktit si dhe shërbimet profesionale të veprimtarisë së AK, sipas objektit të prokurimit. Materialet duhet të jenë funksionale dhe cilësore për realizimin e punës së perdritshme të specialisteve në terren. Specifikimet teknike janë kërkuar në përputhje me kërkesat e specialistëve të terrenit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës ” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave ” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapu e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

1.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ,2023,2024,2025 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/**distributori** i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi)

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklaratë në të cilën të marrë përparësi për përmbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar për çdo produkt sipas kërkesave të AK si dhe realizimin e kontratës sipas afatit 20 ditor.

2.3.9 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Certifikatat ISO Si më poshtë:

Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të përshkruar dhe të notifikuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër mjeti nevojitet të jetë i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të cilin fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- a) Kontratë qiraje.
- b) Leje qarkullimi e mjetit.


- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
 ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori duhet të paraqes një moster fizike për mallin si më poshte.

Nr	Emertimi i Mallit	Njesia	Sasia
1	Kazane plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra	Cope	1



Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, Data 24.04.2026, ora 10:00, pranë Ndermarrjes Komunale Plazh, Durres, me adresë: Lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara .

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- *Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.*
- *Malli do të dorëzohet në prani të komisionit të marrjes në dorëzim në Magazinen e NKP Durrës, lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja.*
- *Furnizimi do të bëhet brenda 20 diteve nga nënshkrimi i kontratës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.*

Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

- *Faturen Tatimore e Mallit*
- *Skeden teknike të produktit*

Mos plotësimi i kriterëve të mësipërme nga ana e Subjektit Ofertues është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.2.2. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. 10 Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Ndërsa në nenin 92, pika 1, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

III.2.3. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në

dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.2.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se : ... Autoriteti kontraktor ka arsyetuar skualifikimin me pretendimin senuk provohet përputhshmëria e kazanëve me standartin EN 840-2:2020. Ndërkohë në katalogun teknik të prodhuesit pjesë e ofertës sonë është deklaruar qartësisht përputhshmëria me standartin EN 840-2. Mungesa e specifikimit formal të vitit 2020 nuk përbën provë për mungesë standari apo mospërputhje teknike të produktit të ofruar. Nëse autoriteti ka pasur ndonjë ndonjë dyshim ishte i lutur të kërkonte të paraqitej specifikisht ISO EN 840-2:2020 ndërkohë që në shtojcë shkruhet kazanet të jene sipas standartit “EN 840-2:2020”. Autoriteti në DST është mjaftuar vetëm me paraqitjen e iso 9001:2015 sic shprehet edhe në Pikën 2.3.2 të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes është

mospërmbushja e një kriteri kualifikimi të përcaktuar (fshehur) në specifikimet teknike të mallrave objekt - prokurimi dhe jo mospërputhja e specifikimeve teknike të mallrave objekt – prokurimi, nga operatori ekonomik ofertues. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, si dhe ka detyrë të përcaktojë kriteret dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me mallrat e kërkuara, por përcaktimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me parashikimet ligjore. Në rastin konkret, KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit kualifikues nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike të mallrave objekt - prokurimi vjen në kundërshtim si me nenin 36, pika 1, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet”, ashtu dhe me nenin 15, pika 1 e 3/b “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se :

”1.Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

c) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

d) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve dhe specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto të fundit duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Duke u kthyer në rastin objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomikë “Leon Kosntruksion” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, duhet të bëhet mbi bazën e kriterëve të kualifikimit të parashikuara në shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit dhe jo në bazë të një kriteri të vendosur (fshehur) në seksionin e specifikimeve teknike, pasi LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcaktojnë qartë përmbajtjen e shtojcave specifike të procedurave të prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” pf , për kualifikimin e operatorit ekonomik “Luar bros” sh.p.k nga autoriteti kontraktor me arsyen se ;

...[Në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, nuk ka paraqitur autroizimet e prodhuesit për mallrat që ka ofertuar të perkthyer nga nje perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise gjithashtu kerkojme qe te verifikohet nese perkthyesi qe ka perkthyer dok eshte pjese e listes se pekthyesve zyrtar te publikuar nga Ministria e Drejtesise ne ëeb e saj <https://ëëë.drejtësia.gov.al/perkthyesit/>, ne menyre qe permbushja e kriterit te jete ne perputhje me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në seksionin IV, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat, autoriteti ka perzgjedhur ne DST gjuhen Shqipe, aq më tepër në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, ne nenin 24 pika 2 parashikohet se Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Pra ligjvenesi ka përkufizuar qartë që ne rastin e procedurave nën kufijte e ulet monetar sikurse procedura objekt ankimi dokumentat e tenderit hartohen ne gjuhen shqipe, gjithashtu edhe ofertat e operatoreve ekonomik duhet te paraqiten ne gjuhet shqip pra te perkthyer nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe, pra per aq kohe qe vete AK ka perzgjedhur ne dokumentat standarte te tenderit gjuhen shqipe sikurse parashikon dhe VKM, nuk arrime te kuptojme se ku eshte mbeshtetur KVO ne kualifikimin e OE LUAR BROSS, ka bere verifikime KVO nese perphyesi eshte nga lista e perkthyesve te miratuar nga Ministria e Drejtesise, si mund te quhet nje document I vlefshem kur ai eshte perkthyer nga nje person ose subject I pa njohur nga Ministria e Drejtesise, akoma me tej si eshte e mundur qe noteri ka noterizuar nje document jo te vlefshem, pra nisur nga ky konkluzion ky operator ekonomik nuk e permbush kriterin ne fjale 2.3.2, AK ka bere nje kualifikim jo vetem ne kundershtim me percaktimet e autoritetit kontraktor ne dokumentat e tenderit por edhe ne kundershtim me nenin 24 te VKM se sipercituar. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit Udhëzime për operatorët ekonomikë ku përcaktohet se: Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme , nuk arrijme te kuptojme sesi e ka kualifikuar KVO kur i gjithe dokumentacioni I paraqitur nga ky operator ekonomik nuk permbush kete kriter pra ne lidhje me autorizimin e prodhuesit nuk eshte ne perputhje me kerkesat e AK ne DST. Si përfundim përsa parashtruam më sipër kërkojmë që të skualifikohet ky operator ekonomik per mos permbushje te kriterit ne fjale per shkak te dorezimit te dokumentacioni jo te plote.], Komisioni vë re se,

III. 3.1 Autoriteti kontraktor në pikën 4.5 , seksioni 1 Njoftimi i kontratës, ka përcaktuar si në vijim kërkesën:

4.5 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

☐

III. 3.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Luar bros ” SHPK , në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Authorization letter ” Datum:24.04.2026 Ihr Zeichen:. Manufacture’s Authorization Letter

 [Authorization Letter.pdf \(114,1 kB\)](#)

III.3.3.Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

III.3.5. Referuar pikës 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”, në këto kushte Komisioni gjykon se, duke qënë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e ulët monetar ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorëzuar duhet ti përmbahet gjuhës së prokurimit. Akoma më tej siç përcaktohet në rregullat e prokurimit publik vetëm në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në rastin konkret kur gjuha e prokurimit është gjuha shqip operatori

ekonomik ofertues duhet të përkthejë dhe noterizojë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin shoqërues të ofertës.

Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Komisioni gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik qëndron, pasi dokumentacioni i dorëzuar duhet të ishte përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik.

III.3.6. Në pikën 4.5 të seksionit i të dokumenteve të tenderit, si dhe në vendimin e këshillit të ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë, që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga agjencia e prokurimit publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se “nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe” në këtë kuadër, i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. gjithashtu, duke u referuar në dst e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun “udhëzime për operatorët ekonomikë” seksioni 1 “**njoftimi i kontratës**”, pika 4.5 “**gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat**” si dhe në vijim në pikën 2 të (përgatitja ofertave) përcaktohet se: oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Luar bros”shpk ka paraqitur, në gjuhë të huaj, “autorizim prodhuesi” të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. në këtë kuadër, komisioni i prokurimit publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor që ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ankimues “Malvina Visoka” pf qëndron.

III.3.7 Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” pf për skualifikimin e operatorit ekonomik “Luar bros” shpk, Komisioni prokurimit publik vlerëson se për sa

kohë që, referuar arsyetimit në pikën III.3.6 të këtij vendimi, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Luar bros” Shpk, do të ndryshojë nga “i kualifikuar” në “i skualifikuar”, duke përmbushur interesin e operatorit ankimues, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3.8. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” pf përse i perket operatorëve ekonomikë “Leon Konstruktion” SHPK, “Zeqir ” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre operatorëve ekonomik është përcaktuar tashmë prej shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik konkretisht në pikën III.1.5 të këtij vendimi si dhe III.2.5 të këtij vendimi, ku këta operatorë ekonomikë rezultojnë se kanë ankimuar skualifikimin e tyre për mospërmbushje të kërkesave/kritereve të pretenduara nga ankimuesi dhe nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë shqyrtimi i pretendimet e ankimuesit rezultojnë te ezuaruara nëpërmjet pikaave III.1.5 dhe III 2.5 këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” pf në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Zeqiri” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
4. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion sh.p.k dhe “Zeqiri” shpk duke i kualifikuar atë sipas konstatimeve të këtij vendimi.

5. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Luar bros” shpk, duke e skualifikuar sipas këtij vendimi.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.
 7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zeqiri ” SHP
 8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” pf.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

